



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRE SHTETI PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

1 VIT SË BASHKU

Raporti XIII
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin shtator 2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA MINISTRE SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Dëshiroj t'ju bëj me dije se ky raport shënon 1 vit komunikim të pandërprerë ndërmjet Institucionit të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe jush, komunitetit të biznesit në vend. Në përmbushje të misionit të ndërmarrë një vit më parë, kemi ndarë me ju çdo muaj raportet e trajtimit të ankesave. Urojmë që kjo urë komunikimi ta ketë forcuar partneritetin ndërmjet Qeverisë dhe Sipërmarrjes me qëllimin parësor lehtësimin e klimës së biznesit dhe nxitjen e ekonomisë, punësimit dhe mirëqeniës në vend.

Si çdo muaj që nga krijimi i këtij institucioni ju raportojmë disa nga kërkesat e ardhura nga ju gjatë muajit shtator si dhe zgjidhjen e ndërmarrë nga zyra jonë. Këto kërkesa/ankesa i gjeni në vijim. Gjatë këtij muaji janë konkretizuar dhe më tej propozimet dhe nismat e diskutuara gjatë takimeve apo tryezave tona, dhe një pjesë e madhe syresh kemi arritur t'i përfshijmë si pjesë të Paketës së re Fiskale që do të prezantohet shumë shpejt nga Qeveria.

Ju lutem vijoni ta konsideroni këtë dokument-raport si vullnet për komunikim intensiv, e sidomos si shteg përmes të cilit të drejtoni çdo shqetësim tuajin.

Mbetem me konsideratë,

Sonila Qato

Regjistri i ankesave të trajtuara

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.1	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	03.09.2018	Subjektet raporton vonesë në rimbursimin e TVSH-së.	Trajtuar me verifikim dhe përgjigje.
Nr.2	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit rural	04.09.2018	Subjekti raporton bllokim të tejzgjatur të kamionit frigoriferik me mall importi nga Maqedonia.	Trajtuar me verifikim, në proces ndjekje me AKU.
Nr.3	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	05.09.2018	Subjekti raporton ndryshim statusi të padrejtë nga biznes i vogël në biznes të madh nga ana e sistemit të tatimeve.	Trajtuar me verifikim dhe përgjigje.
Nr.4	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	06.09.2018	Ankesë për mosbyllje të NIPT nga ana e QKB.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.5	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	07.09.2018	Subjekti kërkon rikontroll tatimor.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.6	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	07.09.2018	Ankesë në lidhje me etikën dhe komunikimin e punonjësve të Doganës së Porto Romanos.	Trajtuar me verifikim dhe përgjigje.
Nr.7	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	08.09.2018	Subjekti raporton gjobitje të padrejtë nga ana e Hetimit Tatimor.	Trajtuar me verifikim dhe zgjidhje.
Nr.8	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	10.09.2018	Ankesa në lidhje me akt bllokimin doganor, pasi malli që shoqëria importon drejt Shqipërisë konsiderohet mbetje e Rrezikshme në bazë të Ligjit 10 463 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".	Trajtuar me përgjigje sqaruese.
Nr.9	Ministria e Mjedisit dhe Turizmit	11.09.2018	Ankesë lidhur me heqjen e një kodi artikulli nga nomenklatura e kombinuar e mallrave, i konsideruar si produkt i rrezikshëm dhe që nuk lejohet të importohet.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	11.09.2018	Subjekti bën kërkesë për rimbursim TVSH-je.	Trajtuar me përgjigje nga QKB.
Nr.11	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	12.09.2018	Subjekti kërkom rimbursim të TVSH-së kreditore.	Trajtuar me përgjigje.

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.12	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	13.09.2018	Subjekti dërgon propozim për përmirësimin e sistemit të administrimit të numrave serial elektronikë të faturave tatimore.	Trajtuar me shqyrtim dhe përgjigje.
Nr.13	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	14.09.2018	Subjekti raporton vonesa të pajustificuara në likuidimin e detyrimeve nga ana e Rajonit Jugor Gjirokastrë.	Trajtuar me verifikim, në proces ndjekje nga ARRSH.
Nr.14	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	15.09.2018	Subjekti raporton refuzim nga QKB të dokumenteve (bilancet e kompanisë) nga portali e-albania.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.15	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	16.09.2018	Subjekti kërkon rivlersim doganor.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.16	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	17.09.2018	Subjekti kërkon rikontroll tatimor.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.17	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	17.09.2018	Subjekti depoziton ankesë për penalizim të padrejtë për kodet tarifore nga dega e Doganës Durrës.	Në proces ndjekjeje.
Nr.18	ZRPP Fier	19.09.2018	Subjekti raporton vonesa në pajisjen me çertifikatë pronësie.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.19	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	20.09.2018	Ankesë lidhur me informalitetin dhe pamundësinë e taksimit për persona të cilët nuk regjistrohen në QKB dhe që kryejnë shërbime të shitjes online përmes rrjeteve sociale.	Hartuar një propozimi i veçantë nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes me synim rregullarizimin e këtij problemi.
Nr.20	ZRPP Librazhd	21.09.2018	Ankesë lidhur me mosregjistrimin e AMTP në ZRPP Librazhd.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.21	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	22.09.2018	Subjekti raporton ankesë për lajmërim jashtë afati nga ana e QKB.	Trajtuar me përgjigje nga QKB.
Nr.22	Ministria e Mjedisit dhe Turizmit	23.09.2018	Subjekti raporton inspektim nga ISHPM pa njoftim paraprak dhe autorizim përkatës.	Trajtuar me verifikim dhe përgjigje.

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.23	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	24.09.2018	Subjekti raporton kontrolle të shpeshta, nisur nga konkurrenca e pandershme.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.24	APP	25.09.2018	Problematikë lidhur me vendosjen e kriterëve diskriminuesë në procedurat e prokurimit lidhur me shërbime që hyjnë në sferën e TIK.	Trajtuar me verifikim dhe përgjigje nga APP.
Nr.25	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	26.09.2018	Ankesë për përzgjedhje jo transparente të shoqatave të turizmit të cilat do të ushtrojnë veprimtarinë në fushën e turizmit.	Trajtuar me shqyrtim dhe përgjigje.
Nr.26	Ministria e Drejtësisë	26.09.2018	Subjekti raporton vështirësi në regjistrimin e kontratave të kalimit të kredisë në sportelet e ADISA.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.27	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	27.09.2018	Subjekti kërkon rikontroll tatimor.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.28	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	28.09.2018	Subjekti raporton mungesë informacioni mbi gjobitjen për punonjës të padeklaruar.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.29	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	28.09.2018	Subjekti raporton probleme lidhur me ndërprerjen e shpeshtë të energjisë elektrike.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.30	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	29.09.2018	Subjekti dërgon ankesë për pezullim të lejes mjedisore.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.31	ZRPP Librazhd	29.09.2018	Subjekti raporton gjobitje nga sistemi megjithëse aktiviteti rezultoi i mbyllur prej dy vitesh.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.32	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	30.09.2018	Subjekti bën kërkesë për anulim aktvlerësimi.	Trajtuar me zgjidhje.

